



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHE

Nr. _____ Prot.

Lezhe, më _____.____.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Sherbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROKURIMIT: “SHERBIMI I MIREMBATJES DHE RIPARIMIT TE
AUTOMJETEVE DHE MJETEVE TE RENDA.**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 50100000-6.

VLERA E FONDIT LIMIT: 17,020,153 (shtatembedhjete milion e njezet mije e njeqind e pesedhjete e tre) Lek pa Tvsh,

ARGUMENTIMI I NJESISE PER MOS NDARJEN ME LOTE TE PROCEDURES:

Duke iu referuar kërkesave dhe nevojave të autoritetit kontraktor Bashkia Lezhe argumenton mosndarjen e procedures në lote, me përmbajtjen si më poshtë:

Kjo procedurë është e pamundur teknikisht të ndahet në kontrata të ndryshme sepse nga vete objekti i prokurimit kemi të bëjmë me nje sherbim te vazhdueshem 24 ore. Riparimet dhe mirëmbajtja e mjeteve, do të kryhet sipas kërkesave teknike dhe në përputhje të plotë me normat dhe standartet e miratuara për këtë qëllim. Riparimet dhe mirëmbajtja e mjeteve pranë Operatorit Ekonomik, do të kryhet në mënyrë periodike. Gjithashtu kontrata parashikon kryerjen e transportit të mjeteve, të cilat janë të difektuara dhe nuk kanë mundësi për vetëlëvizje, nga vend bllokimi i tyre deri në servis, nëpërmjet shërbimit me karrotrec. Po ashtu eshte e nevojshme qe OE-te duhet te disponojne nje pike servisi jo me larg se 3 (tre) km, nga vendodhja e parkut ku gjenden mjetet, me qëllim qe te mos shkaktohen kosto ekstra ne buxhetin e AK-se (karburant, kohe pune te burimeve njerezore etj).

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2 prashikohet shprehimisht se:

“Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, parashikohet shprehimisht:

- 1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.**
- 2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.**

Theksojmë se ndarja ose jo, e kontratës në lote, është një vendim i rëndësishëm që autoriteti kontraktor merr gjatë procesit paraprak pasi ndikon drejtperdrejt në nivelin e pjesmarrjes së operatorëve ekonomike në këtë procedurë prokurimi. Kjo bëhet duke mbajtur në konsideratë elemente të tilla si: tregu, konkurenca e mundshme, vlera e prokurimit, etj., dhe veçanërisht faktin nëse objekti i kontratës është një punë/shërbim/mall për të cilin ofertuesit janë të pakët, pra, gëzojnë në një farë mënyre të drejtën e prodhimit, apo distribucionit.

Në rastin konkret, ndarja në lote e procedurës së prokurimit, do të komplikonte menaxhimin e kontratave dhe shpërndarjen e përgjegjësiave duke e komplikuar realizimin me sukses të kontratës. Në këto kushte, gjykojmë se realizimi i procedurës në një kontratë të pa ndarë në lote është një veprim i drejtë dhe në përputhje me legjislacionin.

Ne vijim AK, bazuar në nenin 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Lezhe ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe termave të referencës si dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituruar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Argumentimi: Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Lezhe ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Kjo pikë e kritereve plotësohet me Kriteret e përgjithshme të pranimit/ vecanta te kualifikimit të plotësuar më sipër. (Shtojcat).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Kërket kjo vlere duke marre ne konsiderate objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj si dhe rendesine e vecante qe shfaq ky sherbim .

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”, ku parashikohet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2 Një dokument që vërteton se subjekti i ka plotësuar të gjitha detyrimet të maturuara të taksave dhe tarifave vendore të vitit 2024, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afatit te ankimimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 43, nenin 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Meqenese operatoret ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës

Këto shërbime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a-Kur shërbime të ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i

përfundimit të kontratës, dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara

ose

b-Kur shërbime e ngjashme janë realizuar me subjekte private si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj si dhe rëndesinë e vecante që shfaq ky shërbim. Përvoja e mëparshme është element shumë i rëndësishëm që garanton autoritetin kontraktor, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së shërbimeve të ngjashme, zotërojnë kapacitete e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses.

2.3.2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 6 persona, për periudhën Maj 2024- Korrik 2024.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin Listëpagesat për periudhën e kërkuar dhe Vërtetim nga sigurimet shoqërore/shëndetësore mbi numrin e të punësuarve.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatit të ankimimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë:

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje për periudhën e kërkuar, tregon besueshmëri për autoritetin që operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është një prove bindëse për AK që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës duke marrë në konsideratë se rëndesinë e këtij shërbimi për AK.

Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit, e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listëpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë për periudhën (Maj 2024- Korrik 2024), punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- 1 (nje) ing. Mekanik (Pergjegjes Teknik), i pajisur me diplome dhe Dëshmi së aftësisë profesionale të përgjegjësit teknik;
- 1 (nje) Punonjes Motorist-Xhenerik, i diplomuar per teknologji automobilash;
- 1 (nje) Mekanik Automjetesh i pajisur me certefikate/dëshmi, te leshuar nga Institucionet perkatese
- 1 (nje) Axhustator, te paisur me deshmi përkatëse;
- 2 (dy) Punonjes Sherbimi

Për punonjësit e mësipërm perveq dokumentacionit te kerkuar mesiper duhet të paraqiten dhe kontrata e punës e vlefshme, Librezat e punes, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajt Maj 2024- Korrik 2024.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afatit te ankimimit.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates pasi nepermjet ketij stafi OE do beje te mundur realizimin me sukses te kontrates. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Prania e stafit teknik per afatin e kerkuar ne listepagesa i verteton AK se operatori ekonomik ka nje staf te qendrushem, operativ i cili do te kryeje sherbimin ne kohe dhe cilesi.

Gjithashtu, në lidhje me disponueshmërinë e stafit teknik të kualifikuar, ky kriter eshte vendosur duke marrë në konsideratë natyrën dhe kohëzgjatjen e shërbimit, me qëllim përmbushjen me sukses te kontrates shfaqet e nevojshme qe OE te kete te punësuar të paktën stafin e mesiper,

Ofrimi i shërbimit të mirembajtjes se automjeteve luan një rol kyc për mbarëvajtjen e punës të institucionit të Bashkisë Lezhë.

Për këtë arsye disponueshëmeria e kërkesave te mësipërme jena në proporcion me natyrën dhe volumin e procedurës së prokurimit si edhe përgjigjet testit të proporcionalitetit duke përmbushur synimin e kërkuar (garantimin e ofritit të shërbimit në përputhje me termat e referencës, kryerjen e shërbimit nga operatorë të kualifikuar e cila lidhet drejtpërdrejtë edhe me jetëgjatësinë e paisjeve në pronësi të autoritetit kontraktor).

Po ashtu eshte e nevojshme disponimi i Ing. Mekanik ne asistimin e kryerjes se sherbimit, pasi mjetet e Bashkise Lezhe jane te kategorive te ndryshme te cilat kushtojne shume dhe mirembajtja e tyre nga punonjes jo profesioniste ndikon negativisht ne jetegjatesine e tyre.

Gjithashtu per realizimin me sukses te kontrates duke marre ne konsiderate numrin e larte te mjeteve nevojiten edhe punonjes ndihmes sherbimi me qellim mirembajtjen dhe riparimin e ketyre mjeteve ne nje kohe sa me te shpejte.

Njesia e prokurimit sqaron se eshte lene e hapur lloji i punonjesve te sherbimit duke pranuar cdo punonjes qe merret me sherbimin e mirembajtjes dhe riparimit te mjeteve.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë në pronesi, me qira ose kontrate bashkepunimi mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

2.3.4/a 3 (tre) vinca statik / ura ngritëse, të instaluar brenda ambjenteve të servisit.

2.3.4/b 1 (nje) mjet “Karotrec”, për transportimin e mjeteve nga vendodhja ku ka ndodhur defekti, drejt servisit.

- Për të provuar disponimin e mjeteve të kërkuar në pike 2.3.4/a, OE duhet të paraqesë fature tatimore blerjeje në emër të tij ose kontrate qiraje/bashkepunimi të vlefshme për gjithë periudhën e kontratës si dhe foto. KVO rezervon të drejtën e verifikimit në objekt të disponimit të urave ngritëse /vinçave.
- Për të provuar disponimin e mjetit të kërkuar në pike 2.3.4/b, OE duhet të paraqesë:
 - Në rast të disponimit të automjetit në pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërtetojnë pronësinë e mjetit: - certifikatën e pronësisë; -leja e qarkullimit; - siguracionin; - taksat vjetore.
 - Ndërsa për mjete të marra me qira/kontrate bashkepunimi krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase/ bashkëpunimit.

Shenim: Kjo kërkesë përmbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatit të ankimimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike, për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i mjetit në pronesi ose qira ose kontrate bashkepunimi është vlerësuar si e nevojshme dhe në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar shërbimit sipas standardeve, grafikut dhe kohëzgjatjes së kontratës. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike. Mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të disponojë në pronesi, me qira ose kontrate bashkepunimi, një pike për larjen e Automjeteve (Lavazh).

a- Për të provuar kriterin e mesiperm OE duhet të paraqesë kontrate qiraje/ Kontrate Bashkepunimi apo Çertifikata/Vertetim Pronesie,

b- Pika për larjen e Automjeteve (Lavazh), detyrimisht duhet të jetë i pajisur me Çertifikatë regjistrimi (QKB).

Shenim: Kjo kërkesë përmbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatit të ankimimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion pajisjet teknike, për të përmbushur kontratën.

Lavazhi ne pronesi ose qira ose kontrate bashkepunimi eshte vlerësuar si e nevojshme dhe në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar sherbimit sipas standardeve, grafikut dhe kohëzgjatjes së kontrates. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike. Mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës.

Kriteri per disponimin e nje pike per larjen e Automjeteve (Lavazh) eshte vendosur bazuar ne preventivin e sherbimit i cili kerkon nder te tjera edhe larjen e automjeteve.

Meqenese ne preventiv eshte kerkuar larja e automjeteve per realizimin e ketij sherbimi eshte e nevojshme disponimi i nje pike per larjen e automjeteve. Po ashtu eshte lene e hapur forma e disponimit si ne pronesi, qira apo kontrate bashkepunimi.

2.3.6 OE duhet te disponoje ne pronesi, me qira ose kontrate bashkepunimi nje pike servisi jo me larg se 3 (tre) km, nga vendodhja e parkut ku gjenden mjetet dhe automjetet (e verifikueshme nga KVO ne ekstraktin e QKB-se ne menyre elektronike)

Parku i mjeteve ndodhet me adrese Rruga Vellezrit Coku, Ish SMT, Lezhe

Kriteri i distances kerkohet per shkak te specifikes se objektit te prokurimit pasi kontraktimi me nje pike servisi me te larget do te shkaktonte kosto ekstra ne buxhetin e Bashkise Lezhe (karburant, kohe pune te burimeve njerezore).

Per te provuar disponimin e pikes se servisit OE duhet te paraqese:

- Ne rast te disponimit te pikes se servisit ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronesine e tij.
- Ndersa per piken e servisit te marre me qira/kontrate bashkepunimi krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qirase/ bashkëpunimit.

2.3.7 Operatori Ekonomik Per piken e servisit sipas kriterit 2.3.6 duhet te disponoje nje grope shërbimi, per manovrimin e mjeteve brenda ambienteve te servisit (ne pronesi ose me qera ose kontrate bashkepunimi).

Per te permbushur kete kriter OE duhet te paraqese Certifikaten e pronesise ose kontrate qiraje/bashkepunimi si dhe foto.

Komisioni i vleresimit te ofertave rezervon te drejten e verifikimit para vleresimit te ofertave.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4 dhe 5, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 5 dhe 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në nje pike servisi jo me larg se 3 (tre) km, nga vendodhja e parkut ku gjenden mjetet dhe automjetet si dhe nje grope sherbimi.

Ky kriter eshte vendosur per te provuar disponueshmerine e pikes se servisit jo me larg se 3 (tre) km, nga vendodhja e parkut ku gjenden mjetet dhe automjetet nga operatori ekonomik dhe per te garantuar ekzekutimin me sukses te kontrates, nese operatori shpallet fitues. Percaktimi i distances prej jo me shume se 3 (tre) km nga vendodhja e parkut ku gjenden mjetet dhe automjetet eshte vendosur per te bere te mundur mos shkaktimin e kostove ekstra ne buxhetin e Bashkise Lezhe (karburant, kohe pune te burimeve njerezore).

Nj.P sqaron se forma e disponimit eshte lene e hapur ne pronesi, me qira ose kontrate bashkepunimi dhe operatoret ekonomike brenda dhe jashte Republikes se Shqiperise qe jane te interesuar per ofertuar mund te lidhe kontrate qiraje ose bashkepunimi me keta subjekte private.

Nj.P thekson se ky kriter nuk kufizon pjesmarrjen ne gare por eshte vendosur per te bere te mundur mos shkaktimin e kostove ekstra ne buxhetin e Bashkise Lezhe (karburant, kohe pune te burimeve njerezore, etj). AK nuk mund te lejoje shkaktimin e kostove extra per riparimin dhe mirembajtjen e mjeteve pasi ne Buxhetin e vitit 2024 te Bashkise Lezhe nuk eshte parashikuar ze tjetër buxhetor qe mund te perballoje keto kosto extra dhe si rrjedhoje mund te sjelle mos riparimin dhe mos mirembajtjen e mjeteve per shkak te largesise nga parku i mjeteve ne piken e servisit.

Po ashtu Njësia e Prokurimit konstaton se në temrat e referencës së procedurës së prokurimit ndër të tjera parashikohet klasifikimi i riparimeve si me poshte:

- a. *Riparime profilaktike (pjesët e ndërrimit që zëvendësohen me kohë përdorimi),*
- b. *Riparime difektsh (zëvendësim pjesë ndërrimi të konsumuara),*
- c. *Riparime të përgjithshme (kthimi i agregatit në parametrat fillestar).*
- d. *Larje e automjeteve*

Për këtë arsye disponueshëmeria e kërkesave të mësipërme janë në proporcion me natyrën dhe volumnin e procedurës së prokurimit si edhe i përgjigjet testit të proporcionalitetit duke përmbushur synimin e kërkuar (garantimin e ofrimit të shërbimit në përputhje me termat e referencës, kryerjen e shërbimit pa shkaktuar kosto extra për AK dhe brenda fondit limit të kontrates).

Gjithashtu në termat e referencës dhe perlllogoritjen e fondit limit se kësaj procedure është parashikuar që ky shërbim të merret brenda një distance prej 3 (tre) kilometrash nga vendodhja e parkut të mjeteve të AK-se.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:

Njesia pergjegjese ka hartuar termat e references, ku thekson se jane shprehur qarte kerkesat AK per realizimin e kontrates.

Njesia pergjegjese ne termat e references argumenton se nuk ka permendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

NJËSIA E PROKURIMIT: